



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: “**A l b G a r d e n**” shpk, me adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në superstradën Lezhë – Shkodër, km 1, Lezhë.

Data: 19/05/2021

- 1. Procedura se prokurimit: “E Hapur”**
- 2. Numri i referencës së procedurës: REF-89452-03-09-2021**
- 3. Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është furnizimi i Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me “**Drure dhe Shkurre Dekorative**”.
- 4. Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “A l b G a r d e n” shpk

K 37513520 N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Çmimi i ofertës është **18 328 700** (tetëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind) lekë **pa Tvsh**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

2. “A.M.E 2020” shpk

K 83725201G

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Çmimi i ofertës është **20 000 000** (njëzet milion) lekë **pa Tvsh**. Nuk ka pasur tërheqje apo modifikim ofertash nga kjo shoqëri.

Subjekte të s'kualifikuara:

- | | | |
|----|---------------------------|-----------------|
| 1. | “ A.M.E 2020” shpk | K 83725201G |
| | Emri i plotë i shoqërisë | numri i NIPT-it |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Nuk plotëson kapacitetin teknik, pika 3/a të DST-ve:

OE nuk plotëson numërin prej 16 punonjesh, siç kërkohet në DST.

Nuk plotëson kapacitetin teknik, pika 3/c të DST-ve:

OE ka ne stafin e tij 5 punonjës të certifikuar për punime në kopshtari, por nga ana e AK është kërkuar 5 punonjës të certifikuar në fidanishte për mirëmbajtjen e bimësisë së përcaktuar deri në momentin e dorëzimit, kjo e bazuar në shkresën e Universitetit Bujqësor të Tiranës me Nr.865/2 prot, date 28.05.2020 ku thekson:

Për punime në fidanishte:

Kërkohet të ketë formim profesional për "Punime në fidanishte", ku përfshihen zera punimesh si, prodhimin e drureve dhe shkurreve në fidanishte dhe mirëmbajtjen e tyre deri në përgatitjen përfundimtare për treg dhe certifikimin e tyre.

Nuk plotëson kapacitetin teknik, pika 8 të DST-ve:

OE nuk ka dorëzuar certifikatën zyrtare model 3 të aneksit 4, autorizimin për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 të aneksit 4 dhe certifikate origjine të lëshuar nga enti shtetëror i farave dhe fidaneve sipas VKM-së Nr. 523, datë 13.07.2016, për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidaneve të bimëve zbukuruese (dekorative).

Si dhe as kontrate furnizimi me një subjekt që është i paisur me certifikatën zyrtare model 3 të aneksit 4, autorizimin për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 të aneksit 4 dhe certifikatë origjine të lëshuar nga enti shtetëror i farave dhe fidaneve sipas VKM-së Nr. 523, datë 13.07.2016, për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidaneve të bimeve zbukuruese (dekorative).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **“A l b G a r d e n” shpk**, me adresë: Lagjja “Skenderbeg”, godinë private 1 katëshe në supëstradën Lezhë – Shkodër, km

1, Lezhë, me nr. Nipti K 37513520 N, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme **18 328 700** (tetëmbëdhjetë milion e treqind e njëzet e tetëmijë e shtatëqind) lekë **pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, Tiranë, me adresë: Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, është paraqitur ankesa me nr. 396 prot, datë 12/03/2021 nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” shpk, dhe i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 396/3 prot, datë 12/03/2021.

Më datë 30/03/2021 pranë autoritetit kontraktor ka ardhur shkresa me nr. 487 prot, nga Komisionit i Prokurimit Publik, për pezullim procedure dhe shqyrtim ankese paraqitur nga operatori ekonomik “A.M.E 2020” shpk i cili ka kundërshtuar vendimarrjes e AK për mospranimin e ankesës së tij.

Në zbatim të vendimit nr. 156/2021 prot, datë 09/04/2021 të Komisionit të Prokurimit Publik, (protokolluar me tonën me nr. 487/2 prot, datë 13/04/2021), AK hartoi Shtojcën sipas vendimit të KPP-së.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11/05/2021

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erinda FINO

Konceptoi: G. Vuksanaj
Kopje: 3 (tre)